

Shërbimet dhe detyrat

Ne ju mbështesim:

- në zhvillimin e njohurive të gjuhës gjermane
- në përfundimin e shkollimit
- në marrjen e një profesioni
- në hyrjen në profesion
- në trajnimin e mëtejshëm gjatë ushtrimit të profesionit
- në njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të huaja
- në ndërmjetësimin drejt zyrave përkatëse

Personat e kontaktit

Arsim i përgjithshëm dhe formim profesional

08441 27-2967

Löwenstr. 2 – 85276 Pfaffenhofen a.d.Ilm

Bildungsberatung@landratsamt-paf.de

Hyrje në profesion si dhe specializime e kualifikime të mëtejshme

08441 27-2965

Löwenstr. 2 – 85276 Pfaffenhofen a.d.Ilm

Bildungscoordination@landratsamt-paf.de

Landratsamt Pfaffenhofen a.d.Ilm

Autori: Landkreis Pfaffenhofen a.d.Ilm
Hauptplatz 22, 85276 Pfaffenhofen a.d.Ilm
Tel.: 08441 27-0 | Fax: 08441 27-271
poststelle@landratsamt-paf.de

Foto: © pixabay

Shënim: Të gjitha shërbimet e departamentit i nënshtrohen dispozitave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale

Data: 2020

ALBANISCH

Zyra konsultuese arsimore
për migrantët

Qarku Pfaffenhofen a.d.Ilm

© pixabay

Bundesministerium für Bildung und Forschung


landkreis-pfaffenhofen.de

■ Përse bëhet fjalë?

Përvetësimi i gjuhës, arsimimi dhe punësimi janë hapa të rëndësishëm gjatë procesit të integritimit. Të mësuarit e gjuhës gjermane dhe kualifikimi përkatës kanë rëndësi për gjetjen e një vendi të përshtatshëm pune.

Departamenti i Integritimit ju informon dhe këshillon për kurset e gjuhës gjermane, për ofertat rajonale arsimore dhe për njohjen e diplomave apo certifikatave nga vendlindja. Departamenti ju orienton dhe mbështet në planifikimin e rrugëtimit individual arsimor e profesional.

Departamenti ofron gjithashtu konsultim edhe për ju si sipërmarrës në qark mbi mundësitë e punësimit, të specializimit apo të kualifikimit të punëtorëve tuaj me prejardhje të huaja.



■ Kujt i adresohemi?

Shërbimet tona të këshillimit i ofrohen të gjithë migrantëve (të rinj), pavarësisht nacionalitetit, lejes së tyre ligjore apo qëllimit të ardhjes në Gjermani.

■ Për çfarë japim konsultë?

Në ju mbështesim me kënaqësi në planifikimin e rrugëtimit tuaj individual arsimor dhe profesional.

■ Konsultë lidhur me përvetësimin e gjuhës

- Të gjitha llojet e kurseve të gjermanishtes, si p.sh.: kurse alfabetizimi, integrimi dhe kurse të gjuhës teknike profesionale
- Kushtet e pjesëmarrjes dhe provimet

■ Konsultë lidhur me arsimimin

- Arsimi shkollor, p.sh.: sistemi arsimor në Gjermani dhe në landin e Bavarisë, kurset mbështetëse dhe përsëritja e provimeve përfundimtare apo njohja e diplomave të huaja

■ Konsultë lidhur me formimin si dhe trajnimin profesional

- Arsimi profesional, trajnimi e vazhdueshme apo specializimet, si p.sh.: Kurset përgatitore për profesionin, formimi profesional dhe ai dual, përvetësimi i kualifikimeve profesionale
- Njohja e kualifikimeve të huaja, mundësitë e mbështetjes personale dhe financiare si dhe qendrat e tjera të këshillimit
- Arsimi i lartë, p.sh.: Llojet e programeve të studimit dhe njohja e diplomave të huaja

■ Konsultë lidhur me punësimin

- Konsulencë për punëdhënës dhe trajnuesit mbi temat, si p.sh.: qendrat e specializuara, mundësitë e mbështetjes financiare për ndërmarrjet, mësimi i gjuhës gjermane në ndërmarrje, puna me institucionet

Këshillimi është falas, konfidencial dhe gjithëpërfshirës. Këshillimi jepet individualisht duke u bazuar në situatën dhe mundësitë personale.